



Funded by
the European Union



Safe data Large bridges Wider borders

Institution-building for alignment with the Union
acquis on the protection of personal data



KOMISIONERI

për të Drejtën e Informimit
dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

“**INFORMIM DHE PRIVATËSI**,”

Revista Nr. 11



CFCU
CENTRAL FINANCE AND CONTRACTING UNIT



GPDP
GARANTE PER LA PROTEZIONE
DEI DATI PERSONALI



LUDWIG
BOLTZMANN
INSTITUTE
Fundamental and Human Rights




Përmbajtja

	faqja
Modernizimi i legjislacionit të mbrojtjes së të dhënave personale, standarde evropiane për qytetarët shqiptarë	3
Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, 40-vjetori i Konventës 108 të Këshillit të Evropës	4
Konventa 108 e KiE - 40 vjet për garantimin e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale	4
Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, aktivitet ndërgjegjësues në shkollën “Servete Maçi”	5
Ndërgjegjësimi i nxënësve dhe mësuesve të shkollave 9-vjeçare për mbrojtjen e të dhënave personale	5
Monitorimi i transparencës proaktive të institucioneve qendrore dhe të varësisë	6
E drejta e informimit për një botë në ndryshim	7
Forcimi i kapaciteteve institucionale në kuadër të legjislacionit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale, zbatimi i Projektit të Binjakëzimit	8
Kuvendi miraton rezolutën për vlerësimin e punës të Zyrës së Komisionerit për vitin 2020	9
Udhëzues i Zyrës së Komisionerit për përpunimin e të dhënave personale gjatë telepunës në kuadër të masave kundër COVID-19	10
Transparenca proaktive, përgjegjësi e Autoriteteve Publike	11
Mbrojtja e të dhënave personale në veprimtarinë e Byrosë Kombëtare të Hetimit	11
Raport monitorimi “Transparenca dhe llogaridhënia në nivelin e qeverisjes vendore”	12
Bashkëpunimi me “Roma Veritas Albania”	12
Faza III e Projektit të Binjakëzimit, njohja e legjislacionit të ri nga institucionet publike	13
Balanca mes dy të drejtave, trajnime në bashkëpunim me ASPA	13
Bashkëpunime me Qendrës Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm	14
Mjedisi digjital, video ndërgjegjësuere për mësuesit dhe nxënësit	14

Revista **“Informim Dhe Privatësi”**

Redaksia: Redi Skënderaj, Alketa Koja, Segi Berberi, Elinda Sulejmani, Denada Hysi.

Modernizimi i legjislacionit të mbrojtjes së të dhënave personale, standarde evropiane për qytetarët shqiptarë



Zyra e Komisionerit dhe Bashkimi Evropian lançuan nismën për modernizimin e kuadrit rregullator në fushën e mbrojtjes së të dhënave, Projektin e Binjakëzimit “Mbështetje institucionit për përafrimin e legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave personale me *acquis* e BE”. Nëpërmjet tij do të përafrohet në legjislacionin shqiptar Rregullorja e Përgjithshme e të Dhënave Personale 2016/679 (GDPR) dhe Direktiva e Policisë 2016/680.

Në ceremoninë e lançimit të ftuar nderi ishin z. Pasquale Stanzione, President i Autoritetit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Italisë, z. Zef Mazi, Kryenegociator i Shqipërisë për negociatat e anëtarësimit në BE, znj. Adea Pirdeni, zëvendësministre e Drejtësisë, z. Mario Mariani, Kreu i Zyrës së Bashkëpunimit në Delegacionin e BE, znj. Jutta Gutzkow, Kreu i Zyrës së Këshillit të Evropës, z. Alberto Petrangeli, zëvendësambasador i Italisë dhe znj. Renate Seib, zëvendësambasadore e Austrisë.

“Sot ndodhemi në një moment hopi cilësor, ku Projekti i Binjakëzimit po vendos bazat më të fuqishme duke garantuar përafrim me Rregulloren e Përgjithshme - GDPR dhe ku Zyra e Komisionerit ka siguruar aderimin në parim të Shqipërisë në Konventën 108+ të Këshillit të Evropës. Demokracia është edhe më e bukur me të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe dinjitetin e njeriut” - theksoi Komisioneri Dervishi në fjalën e tij.



Kuadri i ri rregullator në këtë fushë përbën një kontribut në procesin e integritimit evropian të vendit, e nga ana tjetër, u mundëson qytetarëve shqiptarë standarde të njëjta me ato të BE. Risitë kryesore të tij paraqesin koncepte bashkëkohore që shkojnë paralelisht me zhvillimin e teknologjisë, si mënyra të reja të dhënies së pëlqimit, e drejta për t’u harruar, transportimi i të dhënave, privatësia sipas parazgjedhjes dhe sipas modelit, apo sanksione më të forta. Përafrimi i kuadrit rregullator kombëtar me atë të BE do të forcojë rolin e Zyrës së Komisionerit, për t’u përgjigjur më mirë sfidave e problematikave të cenimit të privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Pjesëmarrësit vlerësuan koordinimin dhe bashkëpunimin efektiv të të gjithë partnerëve dhe u theksua angazhimi për përfundimin në kohë e me cilësi të Projektit. Ai po



zbatohet nga Autoriteti Italian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Garante per la Protezione dei Dati Personali), mbështetur nga CSI-Piemonte në Itali dhe Instituti për të Drejtat dhe Liritë Themelore “Ludwig Boltzmann” në Austri.

Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, 40-vjetori i Konventës 108 të Këshillit të Evropës



28 janari është Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Kjo datë përkoi këtë vit me një moment historik për komunitetin e profesionistëve të privatësisë me 40-vjetorin e

Konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”, e njohur gjerësisht si Konventa 108 e Këshillit të Evropës.

Që prej 1981, ky dokument i rëndësishëm përbën aktin e parë detyrues në hapësirën evropiane në këtë fushë. Shqipëria e ratifikoi Konventën, duke e bërë pjesë të legjislacionit kombëtar, nëpërmjet miratimit të ligjit nr. 9288/2004. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me miratimin e ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” ngriti institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Me hyrjen në fuqi të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, autoriteti u emërtua Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në maj të vitit 2018 miratohet modernizimi i Konventës, duke e emërtuar atë Konventa 108+. Përmirësimet i përgjigjen sfidave të zhvillimit ekonomik-social e teknologjik të viteve të fundit. Modernizimi i saj ecën paralelisht me reformën rregullatore në BE, hyrjen në fuqi të Rregullores së Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR), po në maj të vitit 2018. Aktualisht janë 55 shtete që e kanë ratifikuar Konventën nga Evropa, Amerikat dhe Afrika. Prej 2007, 28 janari është vendosur të kremtohet si Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, ku në shumë vende të botës ajo njihet si “*Privacy Day*”. Videon ndërgjegjësuese të përgatitur me rastin e këtij përvjetori e konsultoni në kanalën zyrtar **YouTube/Komisioneri KDIMDP**.

Konventa 108 e KiE - 40 vjet për garantimin e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale

Në këtë përvjetor, Këshilli i Evropës publikoi një videomesazh kremtues. Pjesë e iniciativës ishte edhe Komisioneri, z. Besnik Dervishi. Në përshëndetjen e tij ai theksoi *rolin e pazëvendësueshëm të Konventës 108, falë edhe modernizimit të saj, që po shtrihet anëmbanë botës, duke promovuar frymën e konvergjencës dhe bashkëpunimit.*



Vidoemesazhi
<https://vimeo.com/504855303>

Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, aktivitet ndërgjegjësues në shkollën “Servete Maçi”

Në kuadër të 28 Janarit-Ditës së Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Zyra e Komisionerit zhvilloi aktivitetin ndërgjegjësues me nxënës dhe mësues të shkollës “Servete Maçi” në Tiranë. Ky takim ishte pjesë e Fushatës Kombëtare “Edukimi digjital, luaj dhe mëso – Happy onlife”, që po mbahet në institucionet e arsimit 9-vjeçar në vend.

Zyra e Komisionerit nuk po promovon thjesht një lojë, por një instrument i cili ka për qëllim të njohë fëmijët/të rinjtë me rreziqet e mjedisit digjital.

Iniciativa synon aftësimin e tyre për sjelljet që duhet të përshtatin, sidomos, gjatë përdorimit të rrjeteve sociale. Për Zyrën e Komisionerit dhe jo vetëm, shkolla është tempulli ku bashkohen mësuesi, fëmija dhe prindi, tre shtyllat më të rëndësishme për të ardhmen e një brez të ri të shëndetshëm profesionalisht, emocionalisht dhe kulturalisht.



Ndërgjegjësimi i nxënësve dhe mësuesve të shkollave 9-vjeçare për mbrojtjen e të dhënave personale

Promovimi dhe ndërgjegjësimi për ushtrimin e të drejtave në praktikë nga qytetarët është një nga drejtimet kryesore të veprimtarisë të Zyrës së Komisionerit.

Në kuadër të Fushatës Kombëtare “Edukimi digjital, luaj dhe mëso-Happy onlife” u zhvilluan, në periudhën maj-qershor 2021, takimet e planifikuara në shkolla 9-vjeçare të qyteteve të Divjakës, Lushnjës, Kuçovës, Dimalit/Ura Vajguore, Beratit, Poliçanit, Patosit, Ballshit, Maliqit, Bilishtit, Korçës dhe Ersekës. Nëpërmjet kësaj loje nxënësit dhe mësuesit pjesëmarrës në këtë projekt njihen me mundësitë dhe me



rreziqet e përdorimit të internetit. Takimet synuan aftësimin e grupmoshës së përzgjedhur, 12-15 vjeç, sidomos, për sjelljet që duhet të përshtatin si në aktivitetin e përditshëm, ashtu edhe në atë virtual. Zyra e Komisionerit parashikon përmblylljen e këtij projekti ndërgjegjësues, i bashkërenduar dhe koordinuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, në muajt shtator-nëntor të vitit shkollor 2021-2022.

Monitorimi i transparencës proaktive të institucioneve qendrore dhe të varësisë



Zyra e Komisionerit në përputhje me parashikimet e ligjit “Për të drejtën e informimit”, realizoi monitorimin e nivelit të transparencës proaktive në 36 Autoritete Publike qendrore dhe të varësisë për vitin 2020. Prezantimi i gjetjeve të këtij monitorimi dhe diskutimi rreth problematikave të konstatuara

u bë gjatë një seance dëgjimore online, me pjesëmarrjen e titullarëve, përfaqësuesve dhe koordinatorë të këtyre Autoriteteve Publike.

Monitorimi u bazua në 5 tregues vlerësimi: publikimi i Programit të Transparencës; publikimi i Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve (për vitin 2020); të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit; publikimi i të dhënave për buxhetin dhe planin e shpenzimeve (për vitin 2020); si dhe instalimi i Regjistrit elektronik për kërkesat dhe përgjigjet për të drejtën e informimit (REKPD).

Programi i Transparencës, si një nga detyrimet kryesore të legjislacionit për të drejtën e informimit, është instrument i rëndësishëm që nxit llogaridhënien, përgjegjshmërinë dhe mirëqeverisjen e Autoriteteve Publike. Njëkëtë raport monitorimit të Zyrës së Komisionerit janë evidentuar mangësi, kryesisht për sa i përket publikimit të të dhënave për shpenzimet buxhetore, por edhe për mos përditësimin e Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve (2020) apo instalimin dhe përdorimin e REKPD. Nga ana tjetër, Autoritetet Publike, në përgjithësi, i kanë përmbushur detyrimet për publikimin e Programit të Transparencës dhe të të dhënave për koordinatorin. Zyra e Komisionerit u kërkoi të pranishmëve në takim që pas njohjes me gjetjet e raportit të marrin masa për përmirësimin e mëtejshëm të nivelit të transparencës proaktive. Ky është raporti i dytë i monitorimit që ka kryer Zyra e Komisionerit për vitin 2020, ku i pari është realizuar për 61 njësitë e vetëqeverisjes vendore.



E drejta e informimit për një botë në ndryshim

Në datat 23-24 qershor 2021 u mbajt Sesioni i Mbyllur i Konferencës së 12-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (*International Conference of Information Commissioners-ICIC*). Me tematikë qendrore “E drejta e informimit për një botë në ndryshim, përdorimi i teknologjisë për të nxitur gjithëpërfshi-rjen” (Access to information for a changing world, using technology to promote inclusion), më shumë se 120 përfaqësues nga mbi 60 autoritete kombëtare/rajonale anëtare të Konferencës dhe me statusin e vëzhguesit morën pjesë në dy ditët e këtij aktiviteti të zhvilluar virtualisht.



Në të u paraqit Raporti Vjetor dhe u raportua për zhvillimet më të fundit në fushën e së drejtës për informim nga të gjitha zonat gjeografike të botës, ndërsa u miratuan këto dokumente të rëndësishme:

- Strategjia 2021-2024;
- Manuali i procedurës, që përcakton mënyrën e funksionimit dhe organizimit të Konferencës, Komitetit Ekzekutiv dhe grupeve të punës;
- Përcaktimi i Komitetit Ekzekutiv si organi që do të zbatojë objektivin e ndryshimit të Kartës së Johannesburgut të 13 marsit 2019;
- Rezoluta “Dhënia në mënyrë proaktive e informacionit në lidhje me Covid-19” (propozuar nga Australia, Zelanda e Re dhe Kanadaja).

Gjithashtu, u shpallën zyrtarisht edhe rezultatet e zgjedhjeve të para për Komitetin Ekzekutiv me mandat 3-vjeçar, në të cilin bën pjesë dhe Zyra e Komisionerit. Organi më i lartë drejtues i organizatës kryesohet nga Instituti Kombëtar për Transparencën, Informacionin dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Meksikës dhe në përbërje të tij janë Zyra e Shërbimeve të Informimit të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës; Zyra e Kontrollorit të Përgjithshëm të Brazilit; Këshilli i Transparencës të Kilit; Rregullatori i Informimit të Afrikës së Jugut; Komisioni për Drejtësi Administrative, Avokati i Popullit të Kenias dhe Komisioneri i Informimit të Bermudës. ICIC funksiononte deri tani nën drejtimin e një grupi të përkohshëm, i udhëhequr nga Komisioneri i Informimit të Mbretërisë së Bashkuar, i cili ndërmori reformimin e thellë të organizatës sipas kritereve të Kartës së Johannesburgut.

Në ditën e dytë të Sesionit të Mbyllur pjesëmarrësit diskutuan rreth temës “Partneriteti në kohë pandemie: Reflektime mbi mënyrën se si e ka mbështetur publikun komuniteti i “Aksesit në informacion” në këtë kohë krize dhe vlerësim i sfidave që mbeten për t’u adresuar”. Nga ana tjetër, Sesioni i Hapur i Konferencës Ndërkombëtare është parashikuar të zhvillohet në formën e webinar-eve/trajtimeve online dhe të përmuajshme deri në fund të vitit 2021.

Forcimi i kapaciteteve institucionale në kuadër të legjislacionit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale, zbatimi i Projektit të Binjakëzimit




Projekti i Binjakëzimit “Mbështetje institucionit për përafrimin e legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave personale me acquis e BE” në etapën e tij të dytë të zbatimit u fokusua në trajnimet me stafin e Zyrës së Komisionerit. Qëllimi ishte njohja e thelluar me procesin e zbatimit të kuadrit rregullator

- GDPR dhe Direktivën e Policisë, nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave më të mira.

Në periudhën mars-qershor 2021 u zhvilluan 6 (gjashtë) module trajnuese me lektorë me eksperiencë shumë vjeçare në këtë fushë, përfaqësues të organizmave zbatuese të Projektit të Binjakëzimit, nga Autoriteti Italian i Mbrojtjes së të Dhënave Personale, CSI-Piemonte, në Itali dhe Instituti për të Drejtat dhe Li-ritë Themelore “Ludwig Boltzmann”, në Austri. Tre ishin objektivat për t’u përmbushur në këtë fazë, të njohur me terminologjinë ndërkombëtare, si “*trajno trajnerët*” (*train the trainers/coaching*):


- a. njohja e stafit me legjislacionin e ri të fushës
- b. rritja e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e kuadrit rregullator;
- c. shkëmbimi i njohurive dhe praktikave më të mira me autoritete partnere nga vendet e BE.

Në këto aktivitete trajnuese u diskutua gjerësisht për aspekte të tilla të rëndësishme të kuadrit të ri rregullator, si përgjegjshmëria dhe llogaridhënia në procesin e përpunimit të të dhënave personale; vlerësimi i riskut për cenimin e privatësisë apo rolet e veçanta të përpunimit të të dhënave personale dhe ndarjen e përgjegjësisë brenda organizatës/institucionit. Me prioritet, u trajtua roli dhe funksionet e nëpunësit përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave (*data protection office*); qasja me parimet e privatësisë sipas parazgjedhjes dhe sipas modelit (*privacy by design and by default*), si dhe rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e regjistrimit të aktiviteteve përpunuese.



Ndër aspektet e legjislacionit evropian të trajtuara në këto trajnime ishin edhe çështje që kanë të bëjnë me promovimin e një sistemi të qeverisjes së privatësisë brenda organizatave, që identifikojnë politikat dhe masat tekniko-organizative apo vlerësimin e ndikimit në mbrojtjen e të dhënave personale (*data protection impact assessments-DPIA*). Po ashtu, u diskutua edhe për elementë të rëndësishëm, si teknologjitë aktuale e ato në zhvillim që ndikojnë në procesin e përpunimit të të dhënave të qytetarëve, për aftësinë për t'u përshtatur me rrethana specifike që ekspozojnë mbrojtjen e të dhënave personale ndaj rreziqeve të mundshme (siç është pandemia botërore COVID-19) dhe për anonimizimin e të dhënave personale.

Tematikat e këtyre trajnimeve për-fshinë edhe marrëdhëniet e përgjegjësitë e kontrolluesit/kontrolluesve të përbashkët apo ato kontrollues-përpunues; kompetencat më të gjera të autoritetit mbikëqyrës, hetimin dhe masat administrative. Kuadri rregullator evropian



i kushton, po ashtu, vëmendje aspekteve të tilla si “pëlqimi” dhe “interesat legjitime” të individit, kodet e sjelljes dhe marrjen, në tërësi, të masave tekniko-organizative për garantimin e një procesi të sigurt apo tran-sferimit ndërkombëtar të të dhënave. Gjatë trajnimeve u fol edhe për certifikimin dhe organet certifikuese që kryejnë/rinovojnë këtë proces, auditimin e organizatave për përmbushjen e detyrimeve të tyre ligjore dhe për menaxhimin e marrëdhënieve me jashtë dhe atyre publike e median.

Kuvendi miraton rezolutën për vlerësimin e punës të Zyrës së Komisionerit për vitin 2020

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, në seancën plenare të datës 3 qershor 2021 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, paraqiti Raportin Vjetor të veprimtarisë së in-stitucionit për vitin 2020.

Sipas procedurës, Kuvendi miratoi dhe Rezolutën “Për vlerësimin e punës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2020”.



<https://www.idp.al/rezolutat-e-kuvendit/>

Udhëzues i Zyrës së Komisionerit për përpunimin e të dhënave personale gjatë telepunës në kuadër të masave kundër COVID-19

Për shkak të situatës të krijuar nga pandemia COVID-19, punëdhënësit me qëllim vazhdimin e aktivitetit të tyre kanë parë si alternativë përdorimin e “telepunës”, si një mënyrë efikase në situata të tilla. Gjatë procesit të “telepunës”, meqenëse ka një devijim të mundshëm nga procedurat standarde të aktivitetit, potencialisht, ekziston mundësi më e lartë për keqpërdorim të qëllimshëm apo aksidental të të dhënave personale. Aplikimi për herë të parë ose rritja e përdorimit të mjeteve të “telepunës” mund të ngrejë si problem çështjen e marrjes së masave shtesë lidhur me sigurinë e të dhënave nga kontrolluesit publik dhe ata privat.

Për rrjedhojë, lind nevoja që punëdhënësit (kontrollues të të dhënave personale) dhe subjektet e të dhënave të orientohen në çështjet e garantimit të standardeve të ruajtjes, përpunimit dhe sigurisë së të dhënave personale. Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit në zbatim të ligjit nr. 9887/2008 “Për



mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, si dhe në vijim të hartimit dhe publikimit të:

1. Udhëzuesit për mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të masave kundër COVID-19;
2. Udhëzuesit për përpunimin e të dhënave personale në sektorë specifikë në kuadër të masave kundër COVID-19”; dhe
3. Udhëzuesit për përpunimin e të dhënave personale sipas Protokolleve të Masave Higjiëno-Sanitare COVID-19,

në periudhën mars-maj 2020, hartoi edhe “Udhëzuesin për përpunimin e të dhënave personale gjatë telepunës në kuadër të masave kundër COVID-19”, për të sjell në vëmendje të çdo pale të interesuar disa aspekte konkrete në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale gjatë “telepunës”, nga situata e krijuar prej pandemisë.

Çdo kontrollues publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, është i detyruar të veprojë në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe mund t’i referohet për orientim në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore këtij udhëzuesi, të cilin e konsultoni të plotë në faqen zyrtare në internet të Zyrës së Komisionerit.

<https://www.idp.al/udhezime-ne-kuader-te-covid-19/>

Transparenca proaktive, përgjegjësi e Autoriteteve Publike

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (LDI), me Urdhërat nr. 187 dhe nr. 188, datë 18.12.2020, miratoi modelet e reja të Programit të Transparencës dhe Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve.

Afati për Autoritetet Publike për publikimin e këtyre formateve të rishikuara ishte brenda datës 31 mars 2021. Përgjatë 3-mujorit të parë të këtij viti, me iniciativën e Zyrës së Komisionerit u zhvilluan takime me koordinatore për të drejtën e informimit të institucioneve qendrore e të varësisë dhe atyre



të pavarura, për t'i asistuar për publikimin e Programit të Transparencës dhe Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve sipas formës dhe për-mbajtjes së modeleve të rishikuara. Nga ky proces konsultimi, Zyra e Komisionerit mori në konsideratë vështirësitë që kanë hasur Autoritetet Publike me situatën e pandemisë COVID-19, por janë konstatuar edhe problematika të karakterit tekniko-organizativ për të vënë në funksion modelet e rishikuara të këtyre dokumenteve. Për këto arsye, Komisioneri, me Urdhërat nr. 35 dhe nr. 36, datë 31.03.2021, vendosi shtyrjen e afatit të sipërpërmendur deri më 30 qershor 2021.

Mbrojtja e të dhënave personale në veprimtarinë e Byrosë Kombëtare të Hetimit


Zyra e Komisionerit ishte pjesë e trajnimit për Byronë Kombëtare të Hetimit (BKH), aktivitet i organizuar nga Zyra në Shqipëri e ICITAP në bashkëpunim dhe koordinim me Prezencën e OSBE.

Anëtarët e kësaj strukture u njohën me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, me funksionet dhe rolin monitorues e mbikëqyrës të Zyrës së Komisionerit, si dhe për raste nga praktika ku ndërthuret kuadri rregullator i fushës me atë që normon objektin e veprimtarisë



së BKH. Njëkohësisht, të pranishmit u trajnuan edhe për çështje që kanë të bëjnë me korrupsionin, integrimin gjinor dhe me përvojën e punës së prokurorive speciale publike nga rajoni i Ballkanit Perëndimor.

Raporti i monitorimit “Transparenca dhe llogaridhënia në nivelin e qeverisjes vendore”



Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) organizoi konferencën për prezantimin e raportit të monitorimit “Transparenca dhe llogaridhënia në nivelin e qeverisjes vendore, një vlerësim krahasues i Programeve të Transparencës në 12 bashki të vendit”.

Qëllimi kryesor i këtij raporti ishte vlerësimi i transparencës proaktive të 12 bashkive qendër qarku (Shkodër, Lezhë,

Kukës, Dibër, Durrës, Tiranë, Elbasan, Fier, Berat, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastër), përmes monitorimit të Programit të Transparencës. Gjetjet dhe rekomandimet e këtij raporti monitorues synojnë të nxisin më tej organet e pushtetit vendor për të rritur nivelin e transparencës përmes publikimit proaktiv të informacionit.

Në Konferencë mori pjesë dhe Komisioneri, z. Besnik Dervishi, i cili vlerësoi raportin dhe punën e të gjitha organizatave të shoqërisë civile (lokale) të angazhuara në monitorimin e Programit të Transparencës të bashkive. Ai, gjithashtu, i ftoi ato për të bashkëpunuar në kërkimin dhe hulumtimin e tyre me qëllim rritjen e transparencës së njësive të vetëqeverisjes vendore. Në këtë aktivitet morën pjesë edhe përfaqësues të njësive të vetëqeverisjes vendore, shoqërisë civile, medias, akademisë dhe aktorë të tjerë kyç vendorë që punojnë dhe kanë interes në çështjet e transparencës, antikorrupsionit dhe llogaridhënies së Autoriteteve Publike.

Bashkëpunimi me “Roma Veritas Albania”

Zyra e Komisionerit bashkëpunoi me organizatën “Roma Veritas Albania” për projektin e saj “Edukimi ligjor i studentëve rom, mediatorëve komunitar dhe të shëndetit për



të lehtësuar aksesin në drejtësi për komunitetin e tyre”. Në trajnimin e mbajtur me pjesëtarë të komunitetit rom/egjiptian, ata u njohën me legjislacionin në të dy fushat e veprimtarisë së institucionit, me rolin dhe funksionet mbikëqyrëse dhe me raste praktike të adresuar apo ku përfshihen pjesëtarë të këtyre komuniteteve. Bashkëpunimi me organizatën RVA do të shtrihet edhe në veprimtari të tjera, ndërsa Zyra e Komisionerit është e gatshme të bashkëveprojë me çdo OjF që nxit dhe forcon zbatimin e të drejtave të qytetarëve.

Faza III e Projektit të Binjakëzimit, njohja e legjislacionit të ri nga institucionet publike

Në kuadër të fazës së tretë të Projektit të Binjakëzimit “Mbështetje institucionit për përafrimin e legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave personale

me *acquis-in* e BE”, u mbajt aktiviteti i parë trajnues për njohjen e kuadrit të ri rregullator dhe ndërgjegjësimin për zbatimin e tij me përgjegjshmëri nga kontrolluesit publik dhe privat (Disseminations events). Ky trajnim virtual, u zhvillua në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA). Në të morën pjesë mbi 60 përfaqësues të institucioneve qendrore dhe të pavarura, ku u trajtuan risitë e legjislacionit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale i përafruar me Rregulloren e Përgjithshme (GDPR) dhe Direktivën e Policisë; ndikimin që do të kenë rregullat e reja për mbrojtjen e të dhënave personale mbi institucionet e administratës publike, si dhe zgjerimi i katalogut të të drejtave “të subjektivit të të dhënave perso-nale” (qytetari). Lektorët në këtë trajnim ishin ekspertë nga partnerët ndërkombëtarë që mbështesin zbatimin e Projektit të Binjakëzimit.



Balanca mes dy të drejtave, trajnime në bashkëpunim me ASPA

Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me ASPA zhvilluan ciklin me 9 trajnime me temë “Balanca midis të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtës për informim”. Në to morën pjesë mbi 180 nëpunës civilë nga Autoritete Publike qendrore e të varësisë, atyre të pavarura dhe njësisive të vetëqeverisjes vendore. Organizimi i trajnimeve u inicua nga raste




praktike dhe vështirësitë e institucioneve në trajtimin në balancë këtyre dy të drejtave kushtetuese. Në to u referuan në tërësi baza ligjore dhe u diskutua mbi dallimin mes informacionit me karakter publik dhe të dhënat personale, publikimi i të cilave cenon jetën private të individëve. Trajnimet

orientuan përfaqësuesit e institucioneve rreth administrimit të të dhënave personale të funksionarëve publikë dhe për kategoritë e tyre që mund të publikohen apo transparencën për procedurat e partneritetit publik/privat. Në trajtime u sollën shembuj nga vendimmarrja e autoritetit dhe ajo ndërkombëtare.

Bashkëpunime me Qendrën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm

Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Qendrën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE) organizuan dy trajnime me tematikë “E drejta e informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale në raport me çështjet e P/CVE – standardi bazë ligjor dhe rastet e kufizimeve të tyre”. Në këto aktivitete ishin të pranishëm stafi i Qendrës dhe



pjesëtarë të rrjetit të bashkëpunëtorëve të saj nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Shërbimi i Provës, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve. Këto Autoritete Publike janë zbatuese të Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm. Në takime u diskutua për legjislacionin për të drejtën e informimit dhe atë për mbrojtjen e të dhënave personale,



rolin dhe funksionet monitoruese/mbikëqyrëse të Zyrës së Komisionerit, si dhe për raste të balancës mes këtyre dy të drejtave apo kur ato kufizohen në raport me objektin e veprimtarisë së CVE. Njohja me liritë dhe të drejtat themelore të njeriut janë në fokus edhe të trajnimeve të ardhshme të Zyrës së Komisionerit dhe CVE.

Mjedisi digjital, video ndërgjegjësuere për mësuesit dhe nxënësit

Zyra e Komisionerit prezantoi ciklin ndërgjegjësuere “Guidë për mësuesit e shkollave 9–vjeçare mbi mbrojtjen e të dhënave personale të nxënësve”. Ai përbëhet nga 9 video dhe bazohet në botimin “Kudri i aftësisë të mësuesve të shkollave 9–vjeçare mbi mbrojtjen e të dhënave personale të nxënësve”. Në epokën digjitale, mësuesit kanë një rol kyç për zgjerimin e njohurive që u japin fëmijëve/të rinjve për përdorimin e përgjegjshëm dhe etik të teknologjive të reja për mbrojtjen e të dhënave personale.



Revista “Informim Dhe Privatësi”

Përgatitet dhe botohet nga

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit

dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Korrik 2021



**Rruga “Abdi Toptani”, Nd. 5
Kodi postar 1001
Tiranë**

**Tel: +355 42237200
Nr. i gjelbër: 08002050
www.idp.al
info@idp.al**